ORGANIT SHQYRTUES TE PROKURIMIT

Sipas nenit 109 te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092

Ndaj:	**KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
Nr. i prokurimit:	**622–23–10590–2–2–1**
Titulli i prokurimit:	**"Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit"**

paraqesim,

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K

rr. "Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7/1

Prishtinë, 10.000

+383 49 525 225

Agron SELIMAJ

agronselimaj@selimajlegal.com

04.12.2023

(Nënshkrimi dhe vula)

SELIMAJ
2007
Legal Consulting sh.p.k.
Prishtinë

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi për kontratë është publikuar me datën 02.10.2023;
- Afati i fundit për dorëzim te tenderit ka qenë me datën 23.10.2023;
- Afati për hapjen e tenderëve ka qenë me datën 23.10.2023 ne ora 14:00;
- Përfundimi i vlerësimit është bere me datën 20.11.2023;
- Kriteri për dhënie te kontratës ka qenë "Çmimi me i ulët"
- Publikimi i Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrat Standarde për Tenderuesit janë bere më datën 20.11.2023;
- Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar kemi pranuar me datën 20.11.2023;
- Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit është bërë me datën 20.11.2023; dhe
- Qasja është mundësuar me datën 21.11.2023;
- Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar me datën 24.11.2023;
- Vendimi refuzues ndaj Kërkesës për rishqyrtim është pranuar me datën 29.11.2023.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve.

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderëve është bere përmes platformës elektronike te prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore qe rregullojnë:

- **Barazinë ne trajtimin/jo diskriminimin** (*neni 7 i LPP lidhur me nenin 58 paragrafin 18 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik, me tutje RrPP*);
- **Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave** (*neni 56 i LPP lidhur me nenin 40 paragrafin 12 te RrPP*);
- **Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve** (*neni 59 i LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 1 te RrPP*);
- **Kriteret për dhënien e kontratës** (*neni 60 i LPP lidhur me nenin 27 paragrafin 3 te RrPP*);
- **Gjendjen ekonomike dhe financiare** (*neni 69 i LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 5 te RrPP*);
- **Aftësinë teknike dhe profesionale** (*neni 69 i LPP lidhur me nenin 26 paragrafin 3 te RrPP*);
- **Tenderët jo normalisht te ulët** (*neni 61 i LPP lidhur me nenin 41 paragrafin 2 dhe 6 te RrPP*).

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Autoriteti kontraktues (me tutje: AK) me datën 20.11.2023 dorëzon Letrën standarde (B42) për tenderuesin e eliminuar, me arsyetimin se "ju mungojnë:

1. "*Tek kontratat e prezantuara ne ofertë çmimet e përcaktuara ne kontratë janë te hijezuara te markuar me ngjyrë te verdh dhe nuk mund te shihet vlera e kontratës*"; dhe

2. "*Lidhur me çmimet e para masave dhe para llogarive te dorëzuara ne ofertë, oferta ka "çmime manipulative" ku sipas rregullores se Odes se Avokatëve te Kosovës....*"

Autoriteti kontraktues, pasi dorëzimit te Kërkesës për rishqyrtim me datën 29.11.2023 nxjerr Vendim refuzues, dhe përveç arsyetimeve te dhëna ne njoftimin për eliminimin e tenderuesit, i shton edhe një pretendim se gjoja "çmimi i ofertës tuaj shpallet jo normalisht i ulet..."

Për shkak te pavërtetësisë se fakteve dhe dëshmive te paraqitura ne Njoftimin dhe Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar OE "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K, dhe per shkak te Vendimit refuzues te AK kundërshtojmë ne tërësi si te pabazuar deklaratat dhe arsyetimet e pretenduara te AK.

Ne vijim ju paraqesim ne detaje shkeljet e legjislacionit te prokurimit publik, dhe atë:

Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminim

Neni 7 paragrafi 1 i LPP përcakton "**Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente**".

Autoriteti kontraktues-Kuvendi Komunal i Prizrenit (me tutje: AK) nuk i ka trajtuar barabartë te gjithë operatorët ekonomik me rastin e krahasimit te çmimeve mes operatoreve ekonomik gjate fazës se vlerësimit te tenderëve, për faktin se:

- Operatori ekonomik i shpallur tenderues i suksesshëm "**Avokat Flaka Gutaj**" B.I ka ofruar çmim te peshuar prej **371,86 euro**, ndërsa Operatori ekonomik "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K (me tutje: OE) ka ofruar çmimin e peshuar prej **158,35 euro.**

Trajtimi i pabarabartë dhe diskriminimi i shpërfaqur i AK është i ndaluar edhe me nenin 58 paragrafin 18 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik, qe përcakton se "**Zbatimi i kritereve duhet t'i ndjek parimet e përgjithshme të trajtimit veçanërisht të barabartë në nenin 7 të LPP-së dhe në pajtim me rregullat e zakonshme të përzgjedhjes në nenin 56 dhe në nenin 65 – 70 të LPP-së".**

Neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave

AK përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar shënon "*Lidhur me çmimet e para masave dhe para llogarive te dorëzuar ne ofertën tuaj, oferta ka çmime manipulative ku sipas rregullores se ODA E AVOKATEVE TE KOSOVES ne bazë te nenit 21.par dhe 41 par.3 piaka 3 e Ligjit nr.04/L – 193 për avokatin...*", dhe paraqet tabelën e përshkrimit te çmimeve, pa ndonjë shënim ne te.

Dispozitat ne te cilat thirret AK kanë te bëjnë me tarifat e avokatëve. Citimi i këtyre dispozitave është ne kundërshtim me Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit (FDT), sepse ne asnjë rresht ne këtë Njoftim apo FDT nuk ceken Tarifat e avokatëve, Rregullorja për tarifat e Avokatëve dhe/apo Ligji për avokatinë. Eliminimi i tenderuesit duke u thirrur ne kritere/kërkesa te paqena ne Njoftimin për kontratën dhe/apo FDT përveç qe përben shkelje ligjore, paraqet edhe tejkalim te kundërligjshëm te kompetencave dhe autorizimeve zyrtare.

Neni 56 paragrafi 3 i LPP përcakton "**Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**".

Një arsyetim i tillë, dhe sidomos shënimi se "*...oferta ka çmime manipulative....*" është tërësisht i papranueshëm dhe do duhej te bartë pasoja ligjore penale dhe civile për cilindo dhe/apo secilin person zyrtar qe ka përpiluar apo lejuar një arsyetim te tillë.

Arsyetimi i AK se OE "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K ka paraqitë ofertë me çmime manipulative është i qëllimshëm për te na denigruar dhe fyer, dhe duke na paraqitur si shoqëri tregtare qe ofron çmime manipulative te na eliminojnë nga gara e mëtejme e këtij procesi te prokurimit publik.

Cilat janë ato çmime manipulative? Perse janë manipualtive këto çmime tona? Cili është qëllimi për te shënuar një fjali te tillë? A ekziston një çmim qe për AK është manipulativ?

Një arsyetim i tillë është edhe ne kundërshtim me nenin 40 paragrafin 12 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe përcakton se "**Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit**".

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK pretendon se "*tek kontratat e prezantuara ne ofertën tuaj Çmimet e përcaktuara ne kontratë janë te hijezuara te markuar me ngjyrë te verdh dhe nuk mund te shihet vlera e kontratës*".

Me mos paraqitjen e Kërkesës për sqarime shtesë ne lidhje me çmimet e hijezuara AK ka shkelur nenin 59 paragrafin 2 te LPP i cili përcakton se "**Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues**".

Edhe pse me çmimin me te ulet, si kriteri i vetëm për shpërblim me tender, AK qëllimisht nuk kërkon sqarime shtesë, konkretisht për çmimet e hijezuara, me interesin për ta na eliminuar nga procesi i tenderimit, edhe pse me ofertën me çmimin me te ulet për kryerjen e shërbimeve.

Me këto veprime AK kryen shkeljen e nenit 38 paragrafin 1 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe përcakton se **"Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një *formular standard* B47 për sqarime për të përdorur nga AK *"Kërkesë për sqarim të tenderit"*. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike"**

Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës

Sipas Njoftimit për kontratë, nenit IV.2) dhe ne Dosjen e tenderit (FDT) ne nenin 30 paragrafin 1 kriter për dhënien e kontratës është "Çmimi me i ulët".

AK ne kundërshtim me vet kriteret dhe kushtet e vendosura për dhënien e kontratës shpall tenderues te suksesshëm tenderuesin me çmimin me te lartë sesa oferta e paraqitura nga "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K.

Neni 60 paragrafi 1 pika 1 i LPP përcakton "**Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**"

Për këtë veprim te kundërligjshëm AK është e vetëdijshme, madje ne paragrafin 3 te Letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm fare nuk shënojnë nëse tenderuesi i suksesshëm ka dorëzuar tenderin ekonomikisht me te favorshëm apo tenderin me çmimin me te ulet. Me mos dhënien e kontratës "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K si ofertuesi me çmimin me te ulet nga konkurrentet tjerë, AK ka shkelur edhe nenin 27 paragrafin 3 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe shënon "**Nëse kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara**"

Neni 68 – Gjendja ekonomike dhe financiare

Sipas nenit III.2.3) te Njoftimit për kontratë dhe nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 te Dosjes se Tenderit (FDT) "*Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi te kënaqshme Autoritetit Kontraktuese se qarkullimi i OE gjatë tri viteve te shkuara (2020, 2021, 2022) ka qene prej jo me pak se 50,000.00 €*".

AK gjatë vlerësimit te tenderëve, me saktësisht vlerësimit te tenderuesit te suksesshëm nuk i është përmbajtur kritereve/kërkesave te cilat vet i ka caktuar.

Tenderuesi i suksesshëm ka ofruar transaksionet bankare te klientëve te vet, e te cilat këto transaksione nuk mund te konsiderohen qarkullim financiar. Këto shifra/shuma te te hollave janë te klientëve, dhe nuk është qarkullim i OE/tenderuesit te suksesshëm.

Për me shumë, edhe pse kërkesë/kritere te caktuara kanë qenë "**pasqyrat e qarkullimit financiar...**" apo "**deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës**", AK ne kundërshtim me kriteret e veta te vendosura nuk e ka vlerësuar te arsyeshme ti kërkoj këto dëshmi nga tenderuesi tani i suksesshëm, përkundër se me datën 01.11.2023 përmes Letrës standarde te kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar dëshmi tjera.

Neni 38 paragrafi 5 i Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik shënon "**Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE**".

"Marrëveshja për pranimin e punëve te kryera ne bazë te kontratës se datës 03.03.2022 për kryerjen e shërbimeve juridike për zyrën e AV.B....K... me seli ne Prizren" për AK do duhej te ishte e papranueshme, marr parasysh se avokati lidh marrëveshje me avokatin tjetër për kryerjen e shërbimeve juridike, dhe për me shumë (*ne bazë te mediave te hapura sociale*) te njëjtit dalin te jenë ne marrëdhënie familjare-bashkëshortë.

Madje, edhe kjo kontratë kësisoj me shumen e shënuar prej **35,309.00** euro, përsëri kriteri i përcaktuar me Njoftimin për kontratë dhe FDT për qarkullimin financiar prej jo me pak se **50,000.00** euro nuk do te arrihej.

Përveç, kësaj ne bazë te qasjes ne dokumentacione, del se tenderuesi i suksesshëm nuk posedon dhe/apo nuk i ka dorëzuar Pasqyrat e qarkullimit financiar apo Deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne ATK me Ofertën për tenderim.

Mungesa e këtyre "dëshmive te kërkuara dokumentare" (*neni III.2.3 i Njoftimit për kontratë*) nga tenderuesi i shpallur i suksesshëm nga AK tregon për shkeljen e nenit 68 paragrafin 1 te LPP qe përcakton se "**Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës**".

Për me tepër, këto kërkesa kanë qenë te specifikuara edhe ne Njoftimin për kontratë dhe FDT, ashtu siç shënon ne nenin 65 paragrafin 3 te LPP se "**Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij**".

Andaj, mungesa e Pasqyrave te qarkullimit financiar dhe/apo Deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne ATK tregon për mungesën e kapaciteteve ekonomike dhe financiare te te tenderuesit te suksesshëm.

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale

AK ka dështuar te siguron edhe referencat e kërkuara me nenin III.2.4) te Njoftimit për kontratë dhe nenit 9 paragrafi 1 dhe 2 te FDT.

Tenderuesi i suksesshëm – Avokat Flaka Gutaj B.I përveç një "kontrate për kryerjen e shërbimeve juridike" me një avokat tjetër B... K...., ka dështuar te siguron te paktën një Referencë me te cilën do te përmbushte kërkesën/kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional te përcaktuar nga AK.

Derisa Kërkesa 1. e nenit III.2.4) është ne shumës "**Projektet te ngjashme...**" dhe dëshmia e kërkuar dokumentare përsëri ne shumës "**Lista e projekteve te ngjashme...me referenca te cilat dëshmojnë ...**", AK ne kundërshtim me nenin 69 paragrafin 4 piken 2 te LPP shpall tenderues te suksesshëm operatorin ekonomik qe ka vetëm një "kontratë" te bashkangjitur ofertës, dhe nuk posedon asnjë Letër reference.

Neni 26 paragrafi 3 i Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik përcakton se "**Nëse autoriteti kontraktues kërkon referenca për realizim të kënaqshëm të kontratave duke specifikuar minimumin e numrit të referencave në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, referencat duhet të jenë për kontratat e specifikuara në Listën e Kontratave dhe duhet të sillen nga anëtari i grupit nëse i njëjti ka qenë ekzekutues i kontratave përkatëse, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbushë nga grupi si tërësi**".

Përkundër se Referencat kanë qenë kriter për tenderim, megjithatë AK shpall tenderues te suksesshëm një Operator ekonomik pa asnjë Letër reference.

Neni 61 - Çmimi jo normalisht i ulet

Kjo pikë është shtuar nga AK ne Vendimin refuzues te datës 28.11.2023, dhe ne jemi obliguar te kundërshtojmë këto pretendime te paarsyetuara te AK.

Tërësisht te papranueshme janë kalkulimet qe i bëhen çmimit te ofertës me te ulet te tenderit. Përkundrazi, sipas kritereve te tenderit kusht ka qenë çmimi me i ulet i peshuar ne përqindje.

Përkundër te gjithave, ka qenë detyrim ligjor i AK te kërkoj sqarime dhe shpjegime ne lidhje me bazën e tenderit nga tenderuesi me çmimin me te ulet apo sic po pretendon kundërligjshëm AK "çmimin jo normalisht te ulet".

Detyrimi i tillë ligjor është i përcaktuar me nenin 61 paragrafin 1 te LPP "**Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni**".

Pretendimi i AK se "*... ne nuk e kemi zhvilluar komunikimin me ju siç e parasheh LPP (INTER PARTES) POR VETTM IU KEMI BERË ME DIJE SE ÇMIMI JUAJ E PLOTËSON EDHE KUSHTIN TË SHPALLET CMIM JONORMALISHT I ULTË*" është i pasaktë, sepse ne Njoftimin për eliminimin nga procesi i tenderimit arsyetimi i vetëm ka qenë se gjoja "*...tek kontratat e prezantuara ne ofertën tuja Çmimet e përcaktuara ne kontrate janë te hijezuara te markuara me ngjyre te verdhe dhe nuk mund te shihet vlera e kontratës*".

Megjithatë, edhe po te ishte "i saktë" ky pretendim i AK, përsëri te njëjtit kanë qenë te detyruar te komunikojnë *inter partes* me tenderuesi me çmimin me te ulet. Ky obligim është i përcaktuar edhe me nenin 41 paragrafin 2 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik "**Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë *inter partes* me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët**"

Për me shumë, neni 41 paragrafi 6 i kësaj Rregulloreje përsëri detyron AK qe "**Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja *"Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët"*.**

Andaj, OSHP i propozojmë qe pas shqyrtimit te pretendimeve tona te prezantuara ne ketë Ankesë, te merr:

VENDIM

1. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K;
2. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 20.11.2023; dhe
3. **DETYROHET** Autoriteti kontraktues dhënien e Kontratës ofertuesit me Çmimin me te ulet OE "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e mësipërme të bëra nga AK pritet të shkaktojnë dëme material të fitimit të projektuar e cila duhet të përcaktohet nga eksperti financiar në rast se paraqitet nevoja për një vlerësim të tillë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ *PUNË* ☐ *FURNIZIM* ☒ *SHËRBIME*

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 02.10.2023

Nr i Prokurimit	**622-23-10590-2-2-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT		
Adresa Postare: Remzi Ademaj		
Qyteti: **PRIZREN**	Kodi postar: **-20000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: Isa Osmankaj	Telefoni: **03820044704**	
Email: **isa.osmankaj@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*):		

Po ☐ Jo ☒
Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒
Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ **Punë**	☐ **Furnizime**	☒ **Shërbime**
☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Prizren

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 12

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

93000000-8

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët *(nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Perpilimi i parashtresave ne proceduren civile dhe procedurat tjera 30% Kontest i vleres se vogel 1 Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro 1 Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte 1 Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte 1 Cmimi total i pozicionit 1 Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera 55% Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel 1 perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro 1 Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte 1 Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte 1 Cmimi total i pozicionit 2 Mjetet juridike ne qeshtjet civile 15% Mjetet 1

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % e vlerës së parashikuar të kontratës**

për 13 muaj kalendarik % e vlerës së kontratës
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës **Po** ☐ **Jo** ☒ *Nëse po,* përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal**

themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së	Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (2020. 2021. 2022) ka qen prej jo më pak se 50.000,00 €	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €. Kërkesa 2 Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve. Dëshmia 2 Çertifikatat përkatëse mbi kualifikimin e kërkuar. origjinale ose të noterizuara në praninë e të punësuarit, kontratat e punës ose të bashkëpunimit me OE për projektin në fjalë.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☒

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ Jo ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ **E hapur**
☐ **E kufizuar**
☐ **Konkurruese me negociata**
☐ **Kuotim i Çmimit**
IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)* Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme

të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ **Jo** ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

ose

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

Po ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:* *data* 23.10.2023 *koha* 14:00:00 *vendi* Prizren
IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar: ☐ Po ☒ Jo *Nëse po,* jep arsyetim
IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☐ Jo ☒ *Nëse po*, vlera e sigurisë së tenderit Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë *apo* muaj
IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: Deri më: data: ditët 90 apo muajt
IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve: **data 23.10.2023 koha 14:00:00 vendi zyra e prokurimit**

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. *Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**622-23-10590-2-2-1**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	**622-23- 195 -221**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K., Afrim Bytyqi nr 17, 20000, Prizren	380.86
2.	SELIMAJ Legal Consluting SH.P.K rr. Garibaldi , hyrja, kati 2 nr 7. 10000	158.35
3.	AVOKAT FLAKA GUTAJ B.T rr. DE RADA " Nr .4,20000	371.86

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna Prizrenit e shpërblen me : **AVOKAT FLAKA GUTAJ B.T rr. DE RADA " Nr .4,20000 ne vlere totale te ofertës 371,86 Euro/te peshuar**
Ose
[shëno emrin e Autoritetit Kontraktues] **anulon**[i] aktivitetin e prokurimit *[Ne rast te anulimit te aktivitetit te prokurimit shëno arsyetimin për anulim]:*
Data:**20/11/2022**
Emri dhe mbiemri i ZPP: Isa Osmankaj

---

[i] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).

[i] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

[i] Ky formular përdoret për anulimin e aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave.

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

Prizren : 20/11/2022

Kontraktuesi : Komuna e Prizrenit, ru. Remzi Ademaj , Pn

Tenderuesi : **AVOKAT FLAKA GUTAJ B.T rr. DE RADA " Nr .4,20000**

Nr. i prokurimit:	622	23	10	5	9	0	2	2	1

Titulli: Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]]* :

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.
Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar [*tenderin ekonomikisht më të favorshëm] [tenderin me çmimin më të ulët]* si përgjigje ndaj *[njoftimit të kontratës] [ftesës për të dorëzuar tenderët në procedurën e kufizuar] [ftesës për të dorëzuar tenderët në procedurën konkurruese me negociata]* për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.
Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj prej **371,86 Euro/te peshuar** *[OPCIONI: pas korrigjimit të gabimeve aritmetikore]* dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Bashkëngjitur me këtë letër është kontrata.

Bashkangjitur: Kontrata
Me respekt,
Isa Osmankaj _____
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm

Prizren : 20/11//2022
Kontraktuesi :Komuna e Prizrenit, Rr. Remzi Ademaj, Pn

Tenderuesi : Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K., Afrim Bytyqi nr 17, 20000, Prizren

Nr. i prokurimit:	622	23	10	5	9	0	2	2	1

Titulli: Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] :

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj **nuk qe tenderi me çmimin më të ulët** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë : **AVOKAT FLAKA GUTAJ B.T rr. DE RADA " Nr .4,20000 ne vlere totale te ofertës 371,86 Euro/te peshuar.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

_____,

Isa Osmankaj

B42 Letër standarde për *[tenderuesin] [kandidatin]* e eliminuar -1

Prizren : 20/11/2023

Kontraktuesi :Komuna e Prizrenit, Rr. Remzi Ademaj, Pn

Tenderuesi : SELIMAJ Legal Consluting SH.P.K rr. Garibaldi , hyrja, kati 2 nr 7. 10000

Nr. i prokurimit:	622	23	10	5	9	0	2	2	1

Titulli: Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit
I/e nderuar(a) *[Z/Znj]]* –

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* [*dokumentet parakualifikuese]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : **Ju mungojnë** :

Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €.

Dështmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dështmuara me referenca të cilat dështmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve.

Verejtje; tek kontratat e prezantuara ne oferten tuja Cmimet e percaktuara ne kontrate jane te hijezuara te markuara me ngjyre te verdhe dhe nuk mund te shihet vlera e kontrates.

2. Lidhur me cmimet e paramasave dhe parallogarive te dorezuar ne oferten tuaj , oferta ka cmime manipulative ku sipas rregullores se ODA E AVOKATEVE TE KOSOVES ne baze te nenit 21.par dhe 41 par.3 piaka 3 e ligjit nr .04 /L -193 per avokatin "Gazeta zyrtare e Rapublikes se Kosoves" r 20 te dt 31 maj 2013.

Sa I perket tarifave te vendosura psh; Perpilimi I parashtresave ne proceduren civile dhe procedura tjera Kontest i vleres se vogel

				Oferta	rregullore
1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%		0
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%		0
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%		0
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 1				0
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%		0
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%		0
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%		0
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 2				0
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%		0
3.1	Mjetet	1	15%		

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_____,

Isa Osmankaj

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108/A të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092

Për:	**KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
Nr. i prokurimit:	**622–23–10590–2–2–1**
Titulli i prokurimit:	**"Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K

rr. "Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7/1

Prishtinë, 10.000

+383 49 525 225

Agron SELIMAJ

agronselimaj@selimajlegal.com

24.11.2023

(Nënshkrimi dhe vula)

SELIMAJ
2007
Legal Consulting sh.p.k.
Prishtinë

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi për kontratë është publikuar me datën 02.10.2023;
- Afati i fundit për dorëzim te tenderit ka qenë me datën 23.10.2023;
- Afati për hapjen e tenderëve ka qenë me datën 23.10.2023 ne ora 14:00;
- Përfundimi i vlerësimit është bere me datën 20.11.2023;
- Kriteri për dhënie te kontratës ka qenë "Çmimi me i ulët"
- Publikimi i Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrat Standarde për Tenderuesit janë bere më datën 20.11.2023;
- Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar kemi pranuar me datën 20.11.2023;
- Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit është bërë me datën 20.11.2023; dhe
- Qasja është mundësuar me datën 21.11.2023.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve.

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Hapja e tenderëve është bere përmes platformës elektronike te prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore qe rregullojnë:

- **Barazinë ne trajtimin/jo diskriminimin** (*neni 7 i LPP lidhur me nenin 58 paragrafin 18 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik, me tutje RrPP*);
- **Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave** (*neni 56 i LPP lidhur me nenin 40 paragrafin 12 te RrPP*);
- **Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve** (*neni 59 i LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 1 te RrPP*);
- **Kriteret për dhënien e kontratës** (*neni 60 i LPP lidhur me nenin 27 paragrafin 3 te RrPP*);
- **Gjendjen ekonomike dhe financiare** (*neni 69 i LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 5 te RrPP*);
- **Aftësinë teknike dhe profesionale** (*neni 69 i LPP lidhur me nenin 26 paragrafin 3 te RrPP*);

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Autoriteti kontraktues (me tutje: AK) me datën 20.11.2023 dorëzon Letrën standarde (B42) për tenderuesin e eliminuar, me arsyetimin se "ju mungojnë:

1. "*Tek kontratat e prezantuara ne ofertë çmimet e përcaktuara ne kontratë janë te hijezuara te markuar me ngjyrë te verdh dhe nuk mund te shihet vlera e kontratës*"; dhe
2. "*Lidhur me çmimet e para masave dhe para llogarive te dorëzuara ne ofertë, oferta ka "çmime manipulative" ku sipas rregullores se Odes se Avokatëve te Kosovës....*"

Për shkak te pavërtetësisë se fakteve dhe dëshmive te paraqitura ne Njoftimin dhe Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar OE "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K, kundërshtojmë ne tërësi si te pabazuar deklaratën dhe arsyetimet e pretenduara.

Ne vijim ju paraqesim ne detaje shkeljet e legjislacionit te prokurimit publik, dhe atë:

Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminim

Neni 7 paragrafi 1 i LPP përcakton "**Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente**".

Autoriteti kontraktues-Kuvendi Komunal i Prizrenit (me tutje: AK) nuk i ka trajtuar barabarte te gjithë operatorët ekonomik me rastin e krahasimit te çmimeve mes operatoreve ekonomik gjate fazës se vlerësimit te tenderëve, për faktin se:

- Operatori ekonomik i shpallur tenderues i suksesshëm "**Avokat Flaka Gutaj**" B.I ka ofruar çmim te peshuar prej **371,86 euro**, ndërsa Operatori ekonomik "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K (me tutje: OE) ka ofruar çmimin e peshuar prej **158,35 euro.**

Trajtimi i pabarabartë dhe diskriminimi i shpërfaqur i AK është i ndaluar edhe me nenin 58 paragrafin 18 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik, qe përcakton se "**Zbatimi i kritereve duhet t'i ndjek parimet e përgjithshme të trajtimit veçanërisht të barabartë në nenin 7 të LPP-së dhe në pajtim me rregullat e zakonshme të përzgjedhjes në nenin 56 dhe në nenin 65 – 70 të LPP-së**".

Neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave

AK përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar shënon "*Lidhur me çmimet e para masave dhe para llogarive te dorëzuar ne ofertën tuaj, oferta ka çmime manipulative ku sipas rregullores se ODA E AVOKATEVE TE KOSOVES ne bazë te nenit 21.par dhe 41 par.3 piaka 3 e Ligjit nr.04/L – 193 për avokatin...*", dhe paraqet tabelën e përshkrimit te çmimeve, pa ndonjë shënim ne te.

Dispozitat ne te cilat thirret AK kanë te bëjnë me tarifat e avokatëve. Citimi i këtyre dispozitave është ne kundërshtim me Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit (FDT), sepse ne asnjë rresht ne këtë njoftim apo FDT nuk ceken Tarifat e avokatëve, Rregullorjaper tarifat e Avokatëve dhe/apo Ligji për avokatinë. Eliminimi i tenderuesit duke u thirrur ne kritere/kërkesa te paqena ne Njoftimin për kontratën dhe/apo FDT përveç qe përmban shkelje ligjore, paraqet edhe tejkalim te kundërligjshëm te kompetencave dhe autorizimeve zyrtare.

Neni 56 paragrafi 3 i LPP përcakton "**Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**".

Një arsyetim i tillë, dhe sidomos shënimi se "...oferta ka çmime manipulative...." është tërësisht i papranueshëm dhe do duhej te bartë pasoja ligjore penale dhe civile për cilindo dhe/apo secilin person zyrtar qe ka përpiluar apo lejuar një arsyetim te tillë.

Arsyetimi se OE "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K ka paraqitë ofertë me çmime manipulative është i qëllimshëm për te na denigruar dhe fyer, dhe duke na paraqitur si shoqëri tregtare qe ofron çmime manipulative te na eliminojnë nga gara e mëtejme e këtij procesi te prokurimit publik.

Cilat janë ato çmime manipulative? Perse janë manipualtive këto çmime tona? Cili është qëllimi për te shënuar një fjali te tillë? A ekziston një çmim qe për AK është manipulativ?

Një arsyetim i tillë është edhe ne kundërshtim me nenin 40 paragrafin 12 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe përcakton se "**Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit**".

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK pretendon se "*tek kontratat e prezantuara ne ofertën tuaj Çmimet e përcaktuara ne kontratë janë te hijezuara te markuar me ngjyrë te verdh dhe nuk mund te shihet vlera e kontratës*".

Me mos paraqitjen e kërkesës për sqarime shtesë ne lidhje me çmimet e hijezuara AK ka shkelur nenin 59 paragrafin 2 te LPP i cili përcakton se "**Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues**".

Edhe pse me çmimin me te ulet, si kriteri i vetëm për shpërblim me tender, AK qëllimisht nuk kërkon sqarime shtesë, konkretisht për çmimet e hijezuara, me interesin për ta na eliminuar nga procesi i tenderimit, edhe pse me ofertën me çmimin me te ulet për kryerjen e shërbimeve.

Me këto veprime AK kryen shkeljen e nenit 38 paragrafin 1 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe përcakton se **"Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një *formular standard* B47 për sqarime për të përdorur nga AK *"Kërkesë për sqarim të tenderit"*. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike"**

Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës

Sipas Njoftimit për kontratë, nenit IV.2) dhe ne Dosjen e tenderit (FDT) ne nenin 30 paragrafin 1 kriter për dhënien e kontratës është "Çmimi me i ulët".

AK ne kundërshtim me vet kriteret e vendosura për dhënien e kontratës shpall tenderues te suksesshëm tenderuesin me çmimin me te lartë sesa oferta e paraqitura nga "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K.

Neni 60 paragrafi 1 pika 1 i LPP përcakton **"Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët"**

Për këtë veprim te kundërligjshëm AK është e vetëdijshme, madje ne paragrafin 3 te Letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm fare nuk shënojnë nëse tenderuesi i suksesshëm ka dorëzuar tenderin ekonomikisht me te favorshëm apo tenderin me çmimin me te ulet. Me mos dhënien e kontrates "SELIMAJ Legal Consulting" SH.P.K si ofertuesi me çmimin me te ulet nga konkurrentet tjerë, AK ka shkelur edhe nenin 27 paragrafin 3 te Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik qe shënon **"Nëse kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara"**

Neni 68 – Gjendja ekonomike dhe financiare

Sipas nenit III.2.3) te Njoftimit për kontratë dhe nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 te Dosjes se Tenderit (FDT) "*Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi te kënaqshme Autoritetit Kontraktuese se qarkullimi i OE gjatë tri viteve te shkuara (2020, 2021, 2022) ka qene prej jo me pak se 50,000.00 €*".

AK gjatë vlerësimit te tenderëve, me saktësisht vlerësimit te tenderuesit te suksesshëm nuk i është përmbajtur kritereve/kërkesave te cilat vet i ka caktuar.

Tenderuesi i suksesshëm ka ofruar transaksionet bankare te klientëve te vet, e te cilat këto transaksione nuk mund te konsiderohen qarkullim financiar. Këto shifra/shuma te te hollave janë te klientëve, dhe nuk është qarkullim i OE/tenderuesit te suksesshëm.

Për me shumë, edhe pse kërkesë/kritere te caktuara kanë qenë "**pasqyrat e qarkullimit financiar...**" apo "**deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës**", AK ne kundërshtim me kriteret e veta te vendosura nuk e ka vlerësuar te arsyeshme ti kërkoj këto dëshmi nga tenderuesi tani i suksesshëm, përkundër se me datën 01.11.2023 përmes Letrës standarde te kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar dëshmi tjera.

Neni 38 paragrafi 5 i Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik shënon "**Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE**".

"Marrëveshja për pranimin e punëve te kryera ne bazë te kontratës se datës 03.03.2022 për kryerjen e shërbimeve juridike për zyrën e AV.B....K... me seli ne Prizren" për AK do duhej te ishte e papranueshme, marr parasysh se avokati lidh marrëveshje me avokatin tjetër për kryerjen e shërbimeve juridike, dhe për me shumë (*ne bazë te mediave te hapura sociale*) te njëjtit dalin te jenë ne marrëdhënie familjare-bashkëshortë.

Madje, edhe kjo kontratë kësisoj me shumen e shënuar prej **35,309.99** euro, përsëri kriteri i përcaktuar me Njoftimin për kontratë dhe FDT për qarkullimin financiar prej jo me pak se **50,000.00** euro nuk do te arrihej.

Përveç, kësaj ne bazë te qasjes ne dokumentacione, del se tenderuesi i suksesshëm nuk posedon dhe/apo nuk i ka dorëzuar Pasqyrat e qarkullimit financiar apo Deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne ATK me ofertën për tenderim.

Mungesa e këtyre "dëshmive te kërkuara dokumentare" (*neni III.2.3 i Njoftimit për kontratë*) nga tenderuesi i shpallur i suksesshëm nga AK tregon për shkeljen e nenit 68 paragrafin 1 te LPP qe përcakton se "**Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës**".

Për me tepër, këto kërkesa kanë qenë te specifikuara edhe ne Njoftimin për kontratë dhe FDT, ashtu siç shënon ne nenin 65 paragrafin 3 te LPP se "**Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij**".

Andaj, mungesa e Pasqyrave te qarkullimit financiar dhe/apo Deklaratat e tatimeve vjetore te dorëzuara ne ATK tregon për mungesën e kapaciteteve ekonomike dhe financiare te te tenderuesit te suksesshëm.

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale

AK ka dështuar te siguron edhe referencat e kërkuara me nenin III.2.4) te Njoftimit për kontratë dhe nenit 9 paragrafi 1 dhe 2 te FDT.

Tenderuesi i suksesshëm – Avokat Flaka Gutaj B.I përveç një "kontrate për kryerjen e shërbimeve juridike" me një avokat tjetër B... K...., ka dështuar te siguron te paktën një Referencë me te cilën do te përmbushte kërkesën/kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional te përcaktuar nga AK.

Derisa Kërkesa 1. e nenit III.2.4) është ne shumës "**Projektet te ngjashme...**" dhe dështmia e kërkuar dokumentare përsëri ne shumës "**Lista e projekteve te ngjashme...me referenca te cilat dështojnë ...**", AK ne kundërshtim me nenin 69 paragrafin 4 piken 2 te LPP shpall tenderues te suksesshëm Operatorin ekonomik qe ka vetëm një "kontratë" te bashkangjitur ofertës, dhe nuk posedon asnjë Letër reference.

Neni 26 paragrafi 3 i Rregullores nr.01/2022 për prokurimin publik përcakton se "**Nëse autoriteti kontraktues kërkon referenca për realizim të kënaqshëm të kontratave duke specifikuar minimumin e numrit të referencave në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, referencat duhet të jenë për kontratat e specifikuara në Listën e Kontratave dhe duhet të sillen nga anëtari i grupit nëse i njëjti ka qenë ekzekutues i kontratave përkatëse, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbushë nga grupi si tërësi**".

Përkundër se Referencat kanë qenë kriter për tenderim, megjithatë AK shpall tenderues te suksesshëm një Operator ekonomik pa asnjë Letër reference.

Andaj, AK i kërkojmë ti rishqyrton me kujdes te shtuar pretendimet tona te prezantuara ne ketë Kërkesë, dhe te merr:

VENDIM

1. **APROVOHET** si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e OE "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K;

2. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 20.11.2023; dhe

3. **REKOMANDOHET** nënshkrimi i kontratës me ofertuesin me Çmimin me te ulet OE "**SELIMAJ Legal Consulting**" SH.P.K.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e mësipërme të bëra nga AK pritet të shkaktojnë dëme material të fitimit të projektuar e cila duhet të përcaktohet nga eksperti financiar në rast se paraqitet nevoja për një vlerësim të tillë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyet

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Prizren 29. 11. 2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prizrenit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **.24. 11. 2023,** të parashtruar nga OE **"SELIMAJ Legal Consoulting" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit" me nr të Prok:** 622-23-10590-2-2-1 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE **"SELIMAJ Legal Consoulting" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit" me nr të Prok:** 622-23-10590-2-2-1 të parashtruar kundër *njoftimit VENDIMIT për dhënie të kontratës* te AK –së, të datës 20. 11. 2023 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .

Vendimi për dhënie të kontratës mbetet në fuqi

A r s y e t i m

OE **"SELIMAJ Legal Consoulting" SHPK** ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit" me nr të Prok:** 622-23-10590-2-2-1

Autoriteti Kontraktues, me dat. 29. 11 2023 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:

Në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, AK ka kontrolluar edhe një herë në detaje dosjen tuaj të ngritur në platformën e eprokurimit dhe ka sjellë të njëjtat të gjetura të cilat iu bëjnë juve të papërgjegjshëm siq janë:

Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €.

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve.

Verejtje; tek kontratat e prezantuara ne oferten tuja Cmimet e percaktuara ne kontrate jane te hijezuara te markuara me ngjyre te verdhe dhe nuk mund te shihet vlera e kontrates.

2. Lidhur me cmimet e paramasave dhe parallogarive te dorezuar ne oferten tuaj , oferta ka cmime manipulative ku sipas rregullores se ODA E AVOKATEVE TE KOSOVES ne baze te nenit 21.par dhe 41 par.3 piaka 3 e ligjit nr .04 /L -193 per avokatin "Gazeta zyrtare e Rapublikes se Kosoves" r 20 te dt 31 maj 2013.

Sa I perket tarifave te vendosura psh; Perpilimi I parashtresave ne proceduren civile dhe procedura tjera
Kontest i vleres se vogel

Oferta

rregullore

1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%		0
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%		0
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%		0
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 1				0
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%		0
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%		0
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%		0
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 2				0
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%		0
3.1	Mjetet	1	15%		

Gjithashttu është konstatuar se oferta juaj e plotëson kriterin që 9mimi juaj i ofertës të shpallet JONORMALISHT I ULËT, pas që në raport me mesataren e ofertave të këtij projekti që është 303.69 euro dhe të cilit çmim kur i zbresim 30 % siq e parashef LPP, del shifra 215.58 euro, çmimi ofertues i juaji prej 158.35 euro, është për 54,23 euro më i ulët se mesatarja e ofertave – 30 %.
Gjithashtu ju plotësoni edhe kushtin e dytë për të qen çmim jonormalisht i ulët sepse çmimi ofertës tuaj është shum më i ulët se 10 % e çmimit të ofertës e cila është mbi çmimin tuaj.

Me që ju jeni shpallë i papërgjegjshëm edhe për arsyet tjera të cilat i cekëm më lartë, Ne nuk e kemi zhvilluar komunikimin me ju siq e parasheh LPP (INTER PARTES) POR VETËM IU KEMI BËRË ME DIJE SE ÇMIMI JUAJ E PLOTËSON EDHE KUSHTIN TË SHPALLET ÇMIM JONORMALISHT I ULËT.

Andaj duke u mbështeë në këto fakte

1. Autoriteti Kontraktues, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Isa Osmankaj
Udhëheqës i sektorit të prokurimit